



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KRYETARI

Nr. 27471 Prot

Roskovec, më 18 . 06 .2020

VENDIM

Nr. 16 datë 18.06 .2020

**“PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT TË KRYETARIT TË BASHKISË  
ROSKOVEC NR.15 DATË 12.06.2020  
“PËR ZHVENDOSJEN E FAMILJEVE PËRKATËSE NË ZBATIM TË  
PROJEKTIT “PËR RIKUALIFIKIM URBAN DHE ZHVILLIMIN E BLOKUT  
NR. 2 QENDRA E QYTETIT ROSKOVEC”**

Në mbështetje dhe ligjit nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” ; të Kodit të Procedurave Administrative neni 112 , pika 1; të ligjit nr.22/2018 “Për strehimin social” neni 6 , pika 1 gërma “c” e tij; të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 361, datë 29.05.2019 „Për përcaktimin e procedurave të zhvendosjes së individëve/familjeve nga vendbanimi a strehimi i tyre, në rastet e parashikuara në ligj, dhe të bashkëpunimit institucional“ ; si dhe të Vendimit të Kryetarit të bashkisë Roskovec nr.15 datë 12.06.2020 “Për zhvendosjen e familjeve përkatëse në zbatim të projektit “Për rikualifikim urban dhe zhvillimin e bllokut nr. 2 qendra e qytetit Roskovec”,

**VENDOSA:**

1.Korrigjimin e gabimit në përlllogaritje të afatit të ekzekutimit të procedurës së zhvendosjes për familjet e caktuara në Vendimin e Kryetarit të bashkisë Roskovec nr.15 datë 12.06.2020 “Për zhvendosjen e familjeve përkatëse në zbatim të projektit “Për rikualifikim urban dhe zhvillimin e bllokut nr. 2 qendra e qytetit Roskovec” si më poshtë:

- Në Vendimin nr.15 datë 12.06.2020 , pika 4 është vendosur:

***“Afati i ekzekutimit të këtij vendimi është data 28.06.2020, orari 08:00 – 17:00. Nuk lejohet ekzekutimi i këtij vendimi në mot jo të favorshëm.Nëse do të rezultojë mot jo i favorshëm atëherë me një tjetër akt amdinistrativ do të caktohet afati i ekzekutimit të zhvendosjes së këtyre dy familjeve”.***

- Pika 4 e këtij vendimi **korrigjohet** si më poshtë:

***“Afati i ekzekutimit të këtij vendimi është data 28.07.2020, orari 08:00 – 17:00. Nuk lejohet ekzekutimi i këtij vendimi në mot jo të favorshëm. Nëse do të rezultojë mot jo i favorshëm atëherë me një tjetër akt amdinistrativ do të caktohet afati i ekzekutimit të zhvendosjes së këtyre dy familjeve”.***

2. Ngarkohet Sekretari-Arkivi për kryerjen e njoftimeve përkatëse.

3. Ndjek zbatimin e këtij vendimi Zëvendëskryetari z. Maksim Goga.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

